Numër:01/518

Datë: 21.08.2024

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK) duke vendosur sipas ankesës të parashtruar me datë 23.07.2024 e të pranuar në AKK me numër protokoli 01-488, datë 25.07.2024, nga Institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" me adresë: Rr.Tirana, në Prishtinë, Republika e Kosovës, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Nr.01/439 të datës 02.07.2024, në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Bazuar në nenin 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr. 01/196 së punës të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 12.08.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" Nr.01-488, datë 25.07.2024, e ushtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr.01/439 të datës 02.07.2024.

II. Mbetet në fuqi vendimi Nr.01/439 i datës 02.07.2024 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

III. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në kompetencat e tij ligjore, vërtetimit të gjendjes faktik dhe analizimit të provave, me datë 02.07.2024 ka nxjerr vendimin Nr.01/439 me të cilin i është refuzuar akreditimi dhe validimi Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" për kualifikimet:

1.1. *Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim i bazuar në Standard Kombëtar (D) me 50 kredi të AAP.*

1.2. *Instalues Eletrik, Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 41 kredi të AAP.*

1.3. *Metalpunues, Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 51 kredi të AAP.*

Institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" i pakënaqur me vendimin Nr.01/439, datë 02.07.2024, me datë 23.07.2024 ka parashtruar ankesë e cila ka mbërrijtur me datë 25.07.2024 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikikmeve, ku është protokoluar dhe ka marrë numër Nr. 01-488, me pretendimin e shkeljes së dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KD të AKK.

Administrimi i Provave: Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e marrjes së vendimit meritor administroj këto prova:

- Vendimin Nr. Nr.01/439, datë 02.07.2024 i Këshillit Drejtues të AKK.
- Ankesën e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" Nr. 01- 488, datë 25.07.2024.
- Komentet e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" mbi të gjeturat në raportin vlerësues për akreditim programi "instalues elektrik", të datës 07.05.2024.
- Komentet e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K"mbi të gjeturat në raportin vlerësues për validim programi "instalues elektrik", të datës 07.05.2024.
- Komentet e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" mbi të gjeturat në raportin vlerësues për akreditim programi "instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli iv kualifikm i bazuar në standard kombëtar, të datës 07.05.2024.
- Komentet e Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" mbi të gjeturat në raportin vlerësues për validim programi "instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli iv kualifikm i bazuar në standard kombëtar", të datës 07.05.2024.

- Materialet shtesë të derguara nga institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" lidhur me komentet e paraqitura:

  - Evidence Fotografike.
  - Detyrat (Testet) Praktike.
  - Kulaifikimi ka përshkrim të qartë të permbajtjes, rezultateve të të nxënit, moduleve obligative dhe zgjedhore.
  - Politikat dhe procedurat për zhvillimin e stafit për vlerësim, verifikim të brendshëm dhe certifikim.
  - Sistemi i dokumentimit për këtë kualifikim-modul është i përshtatshëm dhe mundëson verifikimin e të arriturave individuale të nxënësve-kandidatëve.
  - Komente Shtesë.
  - Prime education- Risk assessment: Entrances and Exit doors for evacuation

- Emailin e datës 08.05.2024 - Përgjigjet e ekipit të ekspertëve të angazhuar nga AKK si vlerësues për kualifikimin "Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit", se qëndrojnë sërish pas konstatimeve të draft- raportit fillestar.

- Emailin e datës 15.05.2024 - Përgjigjet e ekipit të ekspertëve të angazhuar nga AKK si vlerësues për kualifikimin "Instalues elektrik", se qëndrojnë sërish pas konstatimeve të draft- raportit fillestar.

- Emailin e datës 16.05.2024 - Përgjigjet e ekipit të ekspertëve të angazhuar nga AKK si vlerësues për kualifikimin "Metalpunues", se qëndrojnë sërish pas konstatimeve të draft-raportit fillestar.

Këshilli Drejtues i AKK-së pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ushtruar nga Institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" është e pabazuar sepse:

Gjatë shqyrtimit të ankesës janë respektuar në përpikëri dispozitat procedurale të përcaktuara me LPPA. Janë trajtuar të gjithë materialet si dhe janë marrë në konsideratë konstatimet e gjendjes faktike që janë shprehur nga ekipet e ekspertëve të jashtëm vlerësues të AKK-së, të cilat edhe pas shqyrtimit të materialeve shtesë të dërguara nga Institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" lidhur me komentet e paraqitura, janë shprehur se qëndrojnë sërish pranë konstatimeve të draft-raporteve fillestare, se komentet e bëra nga institucioni nuk qëndrojnë dhe rrjedhimisht nuk ka argumente rreth asaj që pohohet në komentet e tyre.

Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e vendosjes në ankesë është mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03./L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren e Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/196, të datës 25.05.2021, si dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në të gjitha shtjellimet e mësipërme, në pajtueshmëri me kompetencat, autorizime, diskrecionin si dhe dispozitat relevante në fuqi, Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën kompetente, brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Valmira Sejdiu

Zv. Kyetar i KD të AKK-së